

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË MES TË

KOMUNËS SË GLLOGOCIT



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC

01 Nr. 400/01-21041
19.06.2020

DHE

RRJETIT TË EDUKATORËVE BASHKËMOSHATARË – PEN



Neni 1
Përfaqësimi i palëve

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje garantojnë se ata kanë autorizimet e nevojshme për përbushjen e obligimeve nga ky memorandum bashkëpunimi, se nënshkruesit e memorandumit të bashkëpunimit kanë zotësinë juridike për lidhje dhe nënshkrimin e së njëjtës në emër dhe për llogari të të njejtëve, dhe se lidhja dhe përbushja e obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje është e lejuar me ligj. Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

1. Komuna e Gllogocit (në vijim "Komuna"), me adresë rr. "Fehmi Lladrovci" 13000, Gllogoc, Republika e Kosovës, përfaqësohet nga Kryetari i Komunës së Gllogocit, z. Ramiz Lladrovci,
2. Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë - PEN (në vijim "PEN"), me adresë rr. Behije Dashi Nr. 5/A Prishtinë 10,000, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 5112039-6 si dhe numrin fiskal 600279253, përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv — z. Bujar Fejzullahu

Më tutje në tekst: PALËT.

Neni 2
Qëllimet

1. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim të krijojë bashkëpunim në mes të Komunës dhe PEN në implementimin e aktiviteteve që dalin nga projekti "Youth Care for Kosovo",

fujizimin e të rinjëve dhe vetëdijësimin e tyre rreth problemeve mjedisore, si dhe mbështetjen e të rinjeve në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave në komunitetet e tyre. Projekti 'Youth Care for Kosovo' mbështetet nga Swedish International Development Cooperation Agency (SIDA) dhe menaxhohet nga Community Development Fund (CDF).

2. Përmes këtij memorandumit të bashkëpunimit synohet realizimi i përbashket i projektit "Youth Care for Kosovo". Ky projekt do të realizohet giatë vitit 2020 deri në fund të vitit 2023 ne mënyrë të vazdueshme dhe do të perfshijë të rinjtë e moshës 15-30 vjeç. duke i angazhuar në rritjen e vetëdijësimit për çështjet e mjedisit dhe u mundësuar qytetarëve të ndërmarrin veprime të drejtpërdrejta në drejtim të përmirësimit të mjedisit brenda komuniteteve të tyre.
3. Palët do të bashkëpunojnë rreth mundësive të inkadrimit të të rinjëve në trajnime dhe aktivitete të ndryshme në komunën e Gllogocit me qëllim të vetëdijësimit të tyre për çështjet e mjedisit, dhe aplikimin e njohurive të fituara në avokimin e politikave më të mira brenda komuniteteve të tyre për çështje mjedisore.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Palet dakordohen të bashkëpunojnë në lidhje me fushat e mëposhtme:

1. Informimin dhe rritjen e kapaciteteve të të rinjëve rreth çështjeve mjedisore, duke i angazhuar në identifikimin e problemeve kryesore mjedisore në komunitete lokale me të cilat përballen qytetarët.
2. Angazhimin e të rinjeve në trajnime për aftesimin e shkathtësive dhe njohurive të tyre rreth problemeve të mjedisit, në mënyrë që të aplikojnë njohuritë e tyre në organizimin e aktiviteteve të ndryshme në këtë komunë.
3. Ngirjten e kapaciteteve të të rinjëve rreth teknologjisë së fundit për matjen e cilësisë së ajrit.
4. Krijimin e grupeve të ndryshme për angazhimin e të rinjëve në ndërmarrjen e kampanjave të ndryshme vetëdijësuese rreth problemeve mjedisore dhe përmirësimit të mjedisit në komunitetet e tyre.
5. Angazhimin e të rinjeve në ligjerata të shumta nëpër shkollat e kësaj komune, duke ju mundësuar nxënësve informimin rreth problemeve mjedisore në komunë dhe mënyrat e përmirësimit të mjedisit.
6. Krijimin e klubeve të gjelbëra në shkollat fillore dhe të mesme publike në këtë komunë për organizimin e aktiviteteve dhe ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme në përmirësimin e mjedisit ku jetojnë.
7. Krijimi i kanaleve efektive te komunikimit në mes komunës dhe të rinjëve të komunës.

Neni 4

Obligimet e palëve

Sipas këtij memorandumi palët pranojnë përgjegjësitë dhe obligohen si vijon:

1. Obligimet dhe përgiegi të e Komunës, përkatësish drejtorisë komunale të arsimit, përfshijnë:
 - a. Identifikimin e shkollave potenciale të kësaj komune për organizimin e aktiviteteve dhe lehtësimin e komunikimit me zyrtarët e shkollave.
 - b. Organizimin e takimit informues me të rinjtë rreth politikave, problemeve dhe programeve komunale mjedisore, në koordinim me PEN.
 - c. Mbështetjen e të rinjëve në ndërmarrjen e iniciativave lokale mjedisore.
 - d. Asistimin e të rinjëve në zhvillimin e hulumtimeve per identifikimin e problemeve kyçë në komunitete lokale.
 - e. Asistimin e PEN dhe të rinjëve në zbatimin e aktiviteteve dhe iniciativave lokale nga periudha qershor 2020 deri dhjetor 2023.
2. Obligimet dhe përgiegi të PEN-it përfshijnë:
 - a. Mbajtjen e takimeve fillestare (zero phase meetings) me vullnetarët e angazhuar nga kjo komunë për t'u njoftuar me qëllimin dhe angazhimin e projektit, si dhe për t'u njoftuar me aktivistët nga komunitat tjetra.
 - b. Mbajtjen e trajnimeve lidhur me hulumtime mbi çështjet mjedisore globale dhe trajtimin e çështjeve lokale me zgjidhje praktike.
 - c. Mbikëqyrjen dhe udhëzimin e të rinjëve nga komuna përgiatë tërë angazhimit te tyre 4 vjeçar (qershor 2020 – dhjetor 2023), në të gjitha aktivitetet e parapara me projekt.
 - d. Menaxhimin e fondeve përgiatë angazhimit të të rinjëve rreth zbatimit të aktiviteteve të parapara.
 - e. Koordinimin e të rinjëve në zhvillimin e hulumtimeve per identifikimin e problemeve kyçë në komunitete lokale.

Neni 5 Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm mes tyre dhe të shkëmbujnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e detyrate të tyre. Komunikimi do të kryhet në mënyrë verbale dhe elektronike.
2. Palet do të caktojnë personat kontaktues që do të janë përgjegjës per shkëmbimin e informatave dhe plotësimit të kërkesave të tyre për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit.
3. Palët do të informojnë njëri-tjetrin mbi personat e kontaktit jo më vone se dy (2) javë nga nënshkrimi i këtij Memorandumi.
4. Personat kontaktues nga të dyja palët do te janë të disponueshëm në çdo kohë per komunikim dhe koordinim, me qëllim të dakordimit për veprimet që duhet të ndërmerren.

Neni 6
Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen që ky memorandum hyn në fuqi në daten e nënshkrimit nga te dyja palët dhe do të zgjase për një periudhë të pacaktuar, përgiatë procesit të zbatimit të aktivitetave të përbashkëta.

Neni 7
Shkëputja e Memorandumit të Bashkëpunimit

1. Ky memorandum i bashkëpunimit mund të shkëputet para afatit të skadimit në marrëveshje nga të dyja palët, apo me kërkesë të njerës palë, me lajmërim paraprak me shkrim në afatin prej dy (2) javësh.
2. Ky memorandum i bashkëpunimit është i bazuar me mirëbesim dhe nuk ka për qëllim të perfitojnë palë të treta. Shkëputja mund të ndodhë në rastin nëse cilado palë është dëmtuar materialisht me veprime të qëllimshme apo nga pakujdesia e palës tjetër.
3. Kjo marrëveshje nuk parashevë implikime financiare në mes të dy palëve.

Neni 8
Gjuha e përdorur

1. Dokumenti i memorandumit të bashkëpunimit në mes Komunës dhe PEN është shkruar në gjuhen shqipe.
2. Sipas nevojave të palëve memorandumi mund të përkthehet edhe në gjuhën serbe apo angleze, me pëlgimin paraprak të palëve.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky memorandum nënshkruhet me datë _____ në Gllogoc dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Neni 10
Dispozitat kalimtare

1. Ky memorandum i bashkëpunimit rregullohet sipas dispozitave të ligieve në fuqi në Kosovë.
2. Ky memorandum i bashkëpunimit mund të modifikohet në cdo kohe me pëlgimin e palëve, dhe kërkesa për modifikim duhet të dorëzohet te pala tjetër së paku dy (2) javë para datës së synuar të modifikimit.
3. Ky memorandum i bashkëpunimit përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën pale.

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatare (PEN)

Bujar Fejzullahu

Drejtor Ekzekutiv



Data: 10/06/2020

Gllogoc

Komuna e Gllogocit

Ramiz Llerovci

Kryetar i Komunes

[Handwritten signature]

